U D H Ë Z I M
Nr.8, datë 30.4.1996

PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE TË SHËRBIMIT AFARISTËVE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.132, datë 6.3.1993 "Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit", ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.288, datë 14.6.1993, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.177, datë 7.4.1995, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

I. Përkufizim

1. Afaristë janë të gjithë tregtarët, shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjet shtetërore sipas përcaktimit që jepet në ligjin nr.7804, datë 10.3.1994 "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë", neni 3, shkronjat a, b, c.

II. Kriteret

2. Pasaportë shërbimi u jepet afaristëve që plotësojnë këto kritere:

a) Të jenë anëtarë të dhomës së tregtisë dhe industrisë në rrethin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe të kenë plotësuar të gjitha detyrimet ndaj saj.

b) Të jenë tregtarë korrektë dhe të mos jenë dënuar për vjedhje, mashtrime ose shkelje të ligjeve fiskale në fuqi.

c) Të mos kenë detyrime ndaj shtetit dhe personave të tretë, si dhe të gëzojnë reputacion të mirë në fushën e biznesit.

ç) Të kenë veprimtari të qëndrueshme në eksport-import dhe të kenë lidhur kontrata të rregullta me shoqëri të huaja.

d) Të kenë bilanc financiar pozitiv dhe në rritje gjatë dy vjetëve të fundit.

Në gjykimin e këtyre kritereve përparësi u jepet afaristëve që ushtrojnë veprimtari në sferën e prodhimit, që kanë punësuar mbi 10 punonjës, që kryejnë veprimtari eksporti, si dhe që kanë kapital qarkullues më të lartë.

3. Afaristëve nuk u akordohet më shumë se një pasaportë shërbimi. Pasaportë shërbimi u jepet administratorit, presidentit ose një personi tjetër të autorizuar prej tyre dhe që është punonjës i shoqërisë.

4. Pasaporta shërbimi u jepen edhe punonjësve drejtues që merren me organizimin, bashkërendimin dhe drejtimin e veprimtarisë së dhomave të tregtisë e industrisë. Kjo të jetë në masën deri 2 pasaporta për dhomat nën 500 anëtarë dhe deri në 4 për dhomat me mbi 500 anëtarë, deri në 4 pasaporta për bashkimin kombëtar të dhomave të tregtisë dhe industrisë dhe deri në dy pasaporta organit mbikëqyrës të veprimtarisë së dhomave, i caktuar me ligjin nr.7804, datë 10.3.1994 "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë".

III. Procedurat e miratimit

5. Afaristët ia paraqesin kërkesat për pasaportë shërbimi kryesisë së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në rreth, së bashku me dokumentet e nevojshme që argumentojnë plotësimin e kritereve të paraqitura në pikat 2 dhe 3.

6. Kërkesat për pasaporta shërbimi shqyrtohen nga asambletë përfaqësuese të dhomave të tregtisë dhe industrisë, të cilat kontrollojnë plotësimin e kritereve të mësipërme. Ato i paraqesin me shkrim Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë propozimet për afaristët që duhen pajisur me pasaporta shërbimi, të cilat të jenë të shoqëruara për secilin me dokumentet sipas pikës 5.

Gjithashtu asambletë përfaqësuese të dhomave në rrethe dhe asambleja përfaqësuese e bashkimit kombëtar të dhomave të tregtisë dhe industrisë i paraqesin Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë edhe propozimet për pajisjen me pasaporta shërbimi të punonjësve drejtues të dhomave sipas pikës 4, të argumentuara për secilin.

7. Kërkesat për pasaporta shërbimi sipas kritereve të mësipërme Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë ia paraqet për miratim Kryetarit të Këshillit të Ministrave për çdo gjashtëmujor, së bashku me mendimin e saj.

8. Dhomat e tregtisë dhe industrisë, kur vërejnë se pas marrjes së pasaportës së shërbimit nga afaristët shkelen kriteret e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, i propozojnë Ministrisë së Industrisë,

Transportit dhe Tregtisë heqjen e kësaj pasaporte, e cila, së bashku me mendimin e saj, ia paraqet Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi